



Breaking News:

Raporti i ngjarjeve, 5,6,7 tetor 2024



Lajmet

Operacionet

07/10/2024

Durrës – Qarkullojnë Me Automjet, Me Armë Zjarri Dhe Lëndë Narkotike, Vihen Në Pranga 2 Shtetas

Durrës/Qarkullojnë me automjet, me armë zjarri dhe lëndë narkotike, kapen dhe vihen në pranga 2 shtetas.

Sekuestrohen 1 armë zjarri pistoletë, një sasi lëndë narkotike kokainë, 2 mjete prerëse (thika), 3 celularë dhe automjeti.

Shërbimet e Policisë, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar edhe në informacionet e siguruar në rrugë operative se dy shtetas lëviznin të armatosur, kanë organizuar punën për kapjen e tyre.

Në kuadër të operacionit "Friends", shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja" kanë ndaluar automjetin e dyshuar. Gjatë kontrollit në automjet u gjetën 1 armë zjarri pistoletë, një sasi lëndë narkotike dhe 3 mjete prerëse (thika), të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me automjetin.

Në përfundim të veprimeve u arrestuan shtetasit M. Gj., 34 vjeç (drejtuesi i automjetit) dhe Y. A., 49 vjeç, të dy banues në Durrës.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Sarandë/Informacion paraprak

Policia e Shtetit, angazhim për nisjen e vitit të ri akademik ▶